



## TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

- Emri i NSH-së:** NSh Industria e Baterive “IBG” Gjilan (“Ndërmarrja”)
- Emri i Ndërmarrjes së Re:** Ndërmarrja e Re IBG Industria Baterive Gjilan Sh.P.K (“Ndërmarrja e Re”)
- Kjo ofertë e Ndërmarrjes së Re përfshin sipërfaqen tokësore së bashku me ndërtesat e fabrikës së prodhimit dhe depot pranë rrugës kryesore, nga Gjilani në Kamenicë. Asetet tjera të mbetura të Ndërmarrjes nuk ofrohen për shitje dhe ato do të privatizohen veçmas.
- Vendndodhja:** Prona e cila tenderohet ndodhet në Komunën e Gjilanit.
- Biznesi/Spektori:** Prodhim Industrial
- Prodhimet:** Aktiviteti kryesor i Ndërmarrjes së Re ka qenë prodhimi i produkteve finale të IBG baterive.
- Tregu:** Aktualisht, nuk ka treg për këtë lloj të produkteve në Kosovë. Megjithatë, ndërtesa e fabrikës dhe të depove të vendosur në një ngastër të tokës afër rrugës kryesore të Gjilanit për në Kamenicë, është në një vend shumë të dëshirueshme. Ajo do të jetë e përshtatshme për një gamë të gjerë të aktiviteteve të biznesit.
- Konkurrenca:** Aktualisht, nuk ka konkurrencë për këtë lloj të produkteve. Konkurrenca do të varet nga sipërmarrja e llojit të bizneseve të ri.
- Punonjësit:** Asnjë punëtorë nuk do të transferohet në Ndërmarrjen e Re.
- Ndërtesat dhe tokat:** Ndërmarrja e Re ofron një mundësi të mundësi të shkëlqyeshme për të blerë ndërtesat e fabrikës së prodhimit dhe të depove në sipërfaqe prej përafërsisht rreth 2.2 hektarëve (22.225 m<sup>2</sup>), të vendosur në një sipërfaqe toke prej përafërsisht rreth 7,5 hektarë (75.231 m<sup>2</sup>), e cila mund të përdoret për zgjerim apo zhvillim alternativë.
- Detyrimet që do të barten:**
- 1) Detyrimet neto të NSH-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjobat, të cilat janë krijuar gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
  - 2) Detyrimet e papaguara të NSH-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
  - 3) Detyrimet e NSH-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSH-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë krijuar gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
  - 4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve ( duke mos i përfshirë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:

- a) Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
- b) Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSH-së.

**Fotoja e  
Ndërmarrjes së Re**

IBG Industria Baterive Gjilan



Departamenti i Shitjes

**Informatat:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +381 (0) 38 500 400 -1255

Fax: + 381 (0) 38 248 076

[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

**Dokumentet e  
Ofertimit:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rr. Ilir Konushevci Nr.8

10000 Pristinë, Kosovë

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezantuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: